

20131643955

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI HOTELIERE**

Neni 1

Në Ligin për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 89/2008, 115/10, 53/11 dhe 141/12), në nenin 60 paragrafët 8 dhe 9 ndryshohen si vijojnë:

"Kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të tregut nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.